



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 353/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.09.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk, në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “*Shërbim me roje private*” – *Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

Ankimues: “Dea Security” sh.p.k
Rruga:”Ndre Mjeda”, Qendra Polifunkionale, Kati I, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Insituti i Shëndeti Publik.
Adresa: Rruga “ Aleksandër Moisiu”, nr.80, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: “Mandi 2K” shpk
Adresa: Njësia Bashkiake nr.5, Rruga: “Nikolla Tupe”, Pallati Verdhë 8 katësh, Kati i parë, Tiranë.

“Nazeri 2000” shpk
Adresa: Rruga “Kavajës”, Qendra Condor, kati II, Tiranë.

“Trezhnjeva” shpk.

Njësia nr.7, ish-Fusha e Aviacionit, Bulevardi i Dafinave, Godina nr.22,
Pll nr.2, Kati III, Ap nr.9, Tiranë.

“Start 2000” shpk.

Adresa: Rruga “Budi”, Nr.19, Tiranë.

“Toni Security” shpk.

Njësia bashkiake nr.5, Rruga “Lidhja e Prizrenit”, zona kadastrale 8270,
P.10/1, kati i parë, Tiranë.

“Eurogjici Security” shpk.

Rruga “Adem Jashari”, Lagjia.18, H.10, Ap.3, Tiranë.

“Snajper Security” shpk.

Adresa: Lagjia “Pjetër Budi”, Rruga “Kont Urani” pranë Gjykatës së
Rrethit Gjyqësor Mat, Burrel Dibër.

“S.S.X” shpk.

Rruga “5 Maji”, (brenda ish-Ndërmarrjes Kimike), Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar,
neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë
29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i
ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë
12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe
Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të
ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi
çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë
procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të bazuar në
pikën 1, të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.06.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “Shërbim me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë.

II.2. Në datën 22.06.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 07.07.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Arbana” sh.a.	00, 0	skualifikuar
2. “Firdeus Security Group” sh.p.k.	00, 0	skualifikuar
3. “Dea Security” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
4. “Eurogjici security” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
5. “Mandi 2K” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
6. “Nazeri 2000” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
7. “S.S.X.” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
8. “SHPSF Snajper Security” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
9. “Start 2000” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
10. “Toni Security” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
11. “Trezhnjeva” sh.p.k.	6863992.76	kualifikuar
12. “Anakonda Security” sh.p.k.	6863992.76	skualifikuar
13. “Kevenjo” sh.p.k.	6863992.76	skualifikuar

II.4. Në datën 09.06.2020, operatori ekonomik “Dea Security” shpk është njoftuar elektronikisht për për vlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe kualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Operatori ekonomik “Dea Security” shpk, në datën 13.07.2020 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

Nëpërmjet kësaj ankese duam të bëjmë prezent një problem që konsiston në shkeljet e kryera nga autoriteti kontraktor “Instituti i Shëndetit Publik”, për procedurën e prokurimit organizuar në datën 22.06.2020 me objekt “Shërbim me roje private e ambienteve të ISHP-së - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj” si më poshtë:
Nga ana e AK në datën 07.07.2020 në mënyrë elektronike është dërguar njoftim mbi klasifikimin e shoqërive pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi.

<i>Operatorët ekonomikë</i>	<i>Vlera të ofertuara</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>“Arbana” sh.a.</i>	<i>00, 0</i>	<i>Po</i>
<i>“Firdeus Security Group” sh.p.k.</i>	<i>00, 0</i>	<i>Po</i>
<i>“Dea Security” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Eurogjici security” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Mandi 2K” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Nazeri 2000” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“S.S.X.” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“SHPSF Snajper Security” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Start 2000” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Toni Security” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Trezhnjeva” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Anakonda Security” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Kevenjo” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>

Sipas këtij klasifikimi jemi njohur se janë kualifikuar pa të drejtë shoqëritë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk për të cilat po ju paraqesim argumentimin tonë si më poshtë:

Së pari, autoriteti kontraktor duhet të skalifikojë shoqëritë Eurogjici Security, S.S.X, Snajper Security, START 2000, Toni Security dhe Trezhnjeva pasi nuk përmbushin kriteret e përgjithshme të kualifikimit pika d), pasi nuk kanë paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve

shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Këto shoqëri kanë gjoba lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Së dyti, autoriteti kontraktor duhet të skalifikojë shoqëritë Eurogjici Security, MANDI- 2K, S.S.X, Snajper Security, START 2000, Toni Security dhe Trezhnjeva, pasi këto shoqëri nuk plotësojnë kërkesën e dhënë në dst, shtojca 1, formulari i ofertës ekonomike pasi nuk kanë plotësuar saktë shpenzimet e detyrueshme ligjore për pagë minimale, shtesa turni i dytë, shtesa turni i tretë dhe sigurime shoqërore për periudhën dhe vendrojet e dhëna në dst. Gjithashtu këto shoqëri nuk plotësojnë kërkesën e dhënë në dst, shtojca 1, pasi nuk kanë plotësuar dhe paraqitur formularin e ofertës sipas formatit dhe tabelës me zërat e dhënë nga AK në dst pasi kanë ndërhyrë në tabelën e dhënë në dst dhe nuk kanë paraqitur formularin e ofertës sipas përcaktimeve të bëra në dst. Nuk kanë plotësuar analizën e kostos për një roje dhe për një vendroje sipas kërkesës së dhënë në DST të 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 7.

Së treti, autoriteti kontraktor duhet të skalifikojë shoqëritë Eurogjici Security, MANDI - 2K, NAZERI - 2000, S.S.X, Snajper Security, START 2000, Toni Security dhe Trezhnjeva pasi këto shoqëri nuk kanë plotësuar të gjitha shtojcat e kërkuara në DST sipas përcaktimeve të AK.

Së katërti, autoriteti kontraktor duhet të skalifikojë shoqëritë Eurogjici Security, S.S.X, Snajper Security, START 2000, Toni Security dhe Trezhnjeva pasi këto shoqëri nuk plotësojnë kërkesën e dhënë në dst, 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, 2.1 “Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomike”, pika 3, certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 11 punonjës shërbimi nga të cilët minimalisht 1 (një) punonjëse të jetë femër, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë. Pra këto shoqëri nuk përmbushin kapacitetin ligjor pasi nuk kanë paraqitur 11 punonjës shërbimi nga të cilët minimalisht 1 (një) punonjëse të jetë femër, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë.

Së pesti, autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë shoqëritë Eurogjici Security, S.S.X, Snajper Security, START 2000, Toni Security dhe Trezhnjeva pasi këto shoqëri nuk i plotësojnë kërkesën e dhënë në dst, 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 3, Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik. Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.

Këto shoqëri nuk përmbushin kapacitetin ekonomik pasi në vërtetimin e performancës së lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë kanë masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.

Përfundimisht nga argumentimi i bërë sa më sipër kërkojmë nga ana e autoritetit të bëhet skualifikimi i këtyre shoqërive, pasi nuk plotësojnë kërkesat e kërkuara në dst.

Shpresojmë që ankesa jonë të merret në konsideratë, pasi në të kundërt ne do ndjekim të gjitha shkallët e ankimit.

II.6. Me anë të shkresës nr. 630/22 prot, datë 17.07.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes, duke mos e pranuar atë.

II.7. Në datën 24.07.2020 operatori ekonomik “Dea Security” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke zvogëluar objektin e ankesës me pretendimet si më poshtë vijon:

Nëpërmjet kësaj ankese duam të bëjmë prezent një problem që konsiston në shkeljet e kryera nga autoriteti kontraktor “Instituti i Shëndetit Publik”, për procedurën e prokurimit organizuar në datën 22.06.2020 me objekt “Shërbim me roje private e ambienteve të ISHP-së - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj” si më poshtë:
Nga ana e AK në datën 07.07.2020 në mënyrë elektronike është dërguar njoftim mbi klasifikimin e shoqërive pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi.

<i>Operatorët ekonomikë</i>	<i>Vlera të ofertuara</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>“Arbana” sh.a.</i>	<i>00, 0</i>	<i>Po</i>
<i>“Firdeus Security Group” sh.p.k.</i>	<i>00, 0</i>	<i>Po</i>
<i>“Dea Security” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Eurogjici security” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Mandi 2K” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Nazeri 2000” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“S.S.X.” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“SHPSF Snajper Security” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Start 2000” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Toni Security” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Trezhnjeva” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Anakonda Security” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>
<i>“Kevenjo” sh.p.k.</i>	<i>6863992.76</i>	<i>Jo</i>

Sipas këtij klasifikimi jemi njohur se janë kualifikuar pa të drejtë shoqëritë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk për të cilat kemi paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me ankesën nr.630/017 prot, datë 17.07.2020, duke e refuzuar ankesën. Për këtë arsye po i drejtohem KPP me arsyetimin të paraqitur si më poshtë:

Së pari, autoriteti kontraktor duhet të skalifikojë shoqëritë Eurogjici Security, S.S.X, Snajper Security, START 2000, Toni Security dhe Trezhnjeva pasi nuk përmbushin kriteret e përgjithshme të kualifikimit pika d), pasi nuk kanë paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Këto shoqëri kanë gjoba lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Së dyti, autoriteti kontraktor duhet të skalifikojë shoqëritë Eurogjici Security, S.S.X, Snajper Security, START 2000, Toni Security dhe Trezhnjeva pasi këto shoqëri nuk plotësojnë kërkesën e dhënë në dst, 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, 2.1 “Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomike”, pika 3, certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 11 punonjës shërbimi nga të cilët minimalisht 1 (një) punonjëse të jetë femër, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë. Pra këto shoqëri nuk përmbushin kapacitetin ligjor pasi nuk kanë paraqitur 11 punonjës shërbimi nga të cilët minimalisht 1 (një) punonjëse të jetë femër, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë

Së treti, , autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë shoqëritë Eurogjici Security, S.S.X, Snajper Security, START 2000, Toni Security dhe Trezhnjeva pasi këto shoqëri nuk i plotësojnë kërkesën e dhënë në dst, 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 3, Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik. Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.

Këto shoqëri nuk përmbushin kapacitetin ekonomik pasi në vërtetimin e performancës së lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë kanë masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.

Përfundimisht nga argumentimi i bërë sa më sipër kërkojmë nga ana e autoritetit të bëhet skualifikimi i këtyre shoqërive, pasi nuk plotësojnë kërkesat e kërkuara në dst.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 630/27 prot, datë 10.08.2020, protokolluar me tonën në datën 11.08.2020 me objekt “Kthim përgjigje” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dea Security” shpk, për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk, me pretendimin se: “Së pari, autoriteti kontraktor duhet të skalifikojë shoqëritë Eurogjici Security, S.S.X, Snajper Security, START 2000, Toni Security dhe Trezhnjeva pasi nuk përmbushin kriteret e përgjithshme të kualifikimit pika d), pasi nuk kanë paguar të gjitha detyrimet

për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Këto shoqëri kanë gjaba lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 7 “Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit”, gërma d) të dokumentave të tenderit të modifikuara, të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a)

b)

c)

ç)

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezultojnë se operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

“Eurogjici Security” shpk “Deklaratë mbi përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme”, që mban datën 22.06.2020, e firmosur nga administratori i shoqërisë dhe që mban vulën identifikuese të shoqërisë në fjalë, si dhe Vërtetim për pagim detyrimesh me nr. T02461869, datë 19.06.2020 në të cilin citohet se: “tatimpaguesi “Eurogjici Security” sh.p.k. rezultojnë se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 19.06.2020, ora 09:26:01”.

“Mandi 2K” shpk “Deklaratë mbi përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme”, që mban datën 22.06.2020, e firmosur nga administratori i shoqërisë dhe që mban vulën identifikuese të shoqërisë në fjalë, si dhe Vërtetim për pagim detyrimesh me nr. T02437955, datë 15.06.2020 në të cilin citohet se:

“tatimpaguesi “Mandi 2K” sh.p.k. rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 15.06.2020, ora 13:07:42”.

“Nazeri 2000” shpk “Deklaratë mbi përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme”, që mban datën 22.06.2020, e firmosur nga administratori i shoqërisë dhe që mban vulën identifikuese të shoqërisë në fjalë, si dhe Vërtetim për pagim detyrimesh me nr. T02462202, datë 19.06.2020 në të cilin citohet se: “tatimpaguesi “Nazeri 2000” sh.p.k. rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 19.06.2020, ora 09:56:25”.

“Snajper Security” shpk “Deklaratë mbi përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme”, që mban datën 22.06.2020, e firmosur nga administratori i shoqërisë dhe që mban vulën identifikuese të shoqërisë në fjalë, si dhe Vërtetim për pagim detyrimesh me nr. T02303130, datë 21.05.2020 në të cilin citohet se: “tatimpaguesi “Snajper Security” sh.p.k. rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 21.05.2020, ora 18:15:13”.

“S.S.X” shpk “Deklaratë mbi përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme”, që mban datën 22.06.2020, e firmosur nga administratori i shoqërisë dhe që mban vulën identifikuese të shoqërisë në fjalë, si dhe Vërtetim për pagim detyrimesh me nr. 2906, datë 27.05.2020 në të cilin citohet se: “tatimpaguesi “S.S.X” sh.p.k rezulton se deri më datë 27.05.2020 nuk ka detyrime në tatim mbi të ardhurat nga punësimi, Tatimin e mbajtur në burim. Rezulton me gjoba për Tatimin mbi vlerën e shtuar, Tatimin mbi fitimin, Kontributet të sigurimeve shoqërore në vlerën 1.156.202 për të cilat shoqëria ka bërë ankimim në Drejtorinë e Apelimeve Tatimore më datë 08.05.2020.”.

“Start 2000” shpk “Deklaratë mbi përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme”, që mban datën 22.06.2020, e firmosur nga administratori i shoqërisë dhe që mban vulën identifikuese të shoqërisë në fjalë, si dhe Vërtetim për pagim detyrimesh me nr. T02444521, datë 16.06.2020 në të cilin citohet se: “tatimpaguesi “Start 2000” sh.p.k. rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 16.06.2020, ora 12:44:11”.

“Toni Security” shpk “Deklaratë mbi përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme”, që mban datën 22.06.2020, e firmosur nga administratori i shoqërisë dhe që mban vulën identifikuese të shoqërisë në fjalë, si dhe Vërtetim për pagim detyrimesh me nr. T02461951, datë 19.06.2020 në të cilin citohet se: “tatimpaguesi “Toni Secuiryt” sh.p.k. rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 19.06.2020, ora 09:32:15”.

“Trezhnjeva” shpk “Deklaratë mbi përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme”, që mban datën 22.06.2020, e firmosur nga administratori i shoqërisë dhe që mban vulën identifikuese të shoqërisë në fjalë, si dhe Vërtetim për pagim detyrimesh me nr. T02449368, datë 17.06.2020 në të cilin citohet se: “tatimpaguesi “Trezhnjeva” sh.p.k. rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 17.06.2020, ora 10:02:51”.

III.1.3. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 15 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes”, përcaktohet se: “Përmbushja e kritereve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit. Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.”.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që dotë prokurohen dhe jodiskriminuese”;

Në nenin 53, pika 3 të LPP-së parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”.

III.1.5. Në nenin 45, pika 2, gërmat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur: d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës”.

III.1.6. Në nenin 15 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se: “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes. “Përmbushja e kritereve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit. Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.”.

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është përcaktuar qartë dhe saktë dokumentat që duhen paraqitur nga ofertuesit për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit parashikuar në shtojcën 7, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë që të plotësojnë dhe dorëzojnë shtojcën 4 vetëdeklaratën me shkrim të subjektit për plotësimin e kriterëve të parashikuar në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit.

KPP konstaton se secili prej operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk kanë dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojcën 4 “Deklaratë mbi Përbushjen e Kriterëve të Përgjithshme” dhe vërtetimet përkatëse që nuk kanë detyrime tatimore të papaguara të lëshuar në mënyrë elektronike nga drejtoria e tatimeve.

Referuar dokumentave të tenderit, Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit, të cilat janë të detyrueshme dhe nuk duhet të ndryshohen në asnjë rast nga autoriteti kontraktor, përcaktohet se ofertuesi duhet të dorëzojë ose deklarojë se ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4. Pra, vërtetimi se operatori ekonomik i cili pretendon të fitojë kontratën, ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. mund të realizohet më së miri me anë të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 4 të dokumentave të tenderit. Akoma më tej, në nenin 15 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar parashikohet se: “*Përbushja e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit. Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.*”.

Sa më sipër, KPP gjykon se operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk kanë dorëzuar dokumentacion të rregullt, ku përveç shtojcës 4 kanë dorëzuar edhe vërtetimet të lëshuar në mënyrë elektronike që vërtetojnë se këta operatorë nuk kanë detyrime tatimore të papaguara, duke përbushur në mënyrë rigoroze kriteret e përgjithshme të pranim / kualifikimit të parashikuara në dokumentat e tenderit objekt ankim

Ndërsa operatori ekonomik “S.S.X” shpk ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojcën 4 “Deklaratë mbi Përbushjen e Kriterëve të Përgjithshme” dhe vërtetimin nr. 2906, datë 27.05.2020 në të cilin citohet se: “*tatimpaguesi “S.S.X” sh.p.k rezulton se deri më datë 27.05.2020 nuk ka detyrime në tatim mbi të ardhurat nga punësimi, Tatimin e mbajtur në burim. Rezulton me gjoba për Tatimin mbi vlerën e shtuar, Tatimin mbi fitimin, Kontributet të sigurimeve shoqërore në vlerën 1.156.202 për të cilat shoqëria ka bërë ankimim në Drejtorinë e Apelimeve Tatimore më datë 08.05.2020.*”.

Duke qenë se një situatë e tillë nuk rregullohet nga lex specialis, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për interpretimin e togfjalëshit “*detyrim tatimor*” në rastet kur akti administrativ “*Njoftim vlerësimi tatimor*” është në proces ankimi, do të konsiderohet ose jo “detyrim” për qëllim të kualifikimi në procedurat e prokurimit publik, gjykon ti drejtohet për interpretim sistematik (*domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brënda sistemit juridik*). Për të arritur në vendimarrje të drejtë,

K.P.P. gjykon se duhet ti drejtohet, ligjit të posaçëm (*lex specialis*) Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSh” të ndryshuar, në nenin 6 pika 3 parashikon se “Me detyrim tatimor” nënkupton “tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”.

Komisioni i Prokurimit Publik, për të arritur në vendimarrje vlerësoi se duhej të kishte parasysh:

- jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (shiko Vendimin nr.16, datë 25.07.2008) - në bazë së të cilës janë bërë dhe ndryshime në legjislacionin tatimor;
- Vendimin Unifikues nr.4, datë 30.05.2011 të Gjykatës së Lartë – i cili shprehet se:

“Me “detyrim tatimor”, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6/3 nënkupton “tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”.

Dallohet qartësia në ligj që, për t’u marrë në shqyrtim ankimi, detyrimisht duhet që të parapaguhet, sipas aktit administrativ Njoftim-Vlerësimit, detyrimi tatimor, i cili duhet të ketë të përfshirë tatimin dhe kamatëvonesat.

Gjobat, megjithëse konsiderohen sipas nenit të cituar, si pjesë e detyrimit tatimor, nuk përfshihen, si pjesë e parapagimit të detyrimit, si një kusht i domosdoshëm për të marrë në shqyrtim ankimin administrativ.”.

- Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSh” (ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, dt. 28.12.2013), neni 107 i të cilit parashikon se:

1. “Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

2. Shuma e pagueshme ose shuma e vënë si garanci bankare, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton vendosjen e garancisë, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.”.

- Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 të Ministrit të Financave që parashikon se:

“Shuma e detyrimit për t’u paguar përfshin vetëm shumën e tatimit dhe interesin, nëse ka, në aktin administrativ që ankimohet, që është i pagueshëm në momentin e ankimit, duke përjashtuar gjobat e përfshira në aktin administrativ objekt ankimi”.

Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se: “operatori ekonomik “S.S.X” shpk nuk përmbush kriteret e përgjithshme të kualifikimit pika d), pasi nuk ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Kjo shoqëri ka gjoba lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, kur me këto të fundit nënkuptohen gjoba të cilat janë në proces ankimi, nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurimin publik. Komisioni vlerëson të adoptojë një interpretim të ngushtë e teleologjik të togflalëshit “detyrimet për pagimin e tatimeve” të parashikuar nga neni 45, pika 2, gërma “dh” i Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar), në funksion të një prej qëllimeve të këtij ligji, që është nxitja e pjesëmarrjes dhe e konkurrencës së operatorëve ekonomikë, në kuptim të rritjes së efikasitetit dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit publik. Në balancën mes përpjekjes për të siguruar pagesën e plotë të të gjithë elementëve të detyrimit tatimor, nga njëra anë, dhe mirpërdorimin e fondeve publike –

që arrihet përpara së gjithash përmes një pjesmarrje të gjerë e konkurruese të operatorëve ekonomikë, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ato raste kur nga operatori pjesmarrës në procedurën e prokurimit është paguar tatimi përkatës dhe interesi, ndërkohë që gjoba është në proces ankimimi, nuk mund të ngrihet si pretendim dhe të shërbej si arsye skualifikimi.

Sa më sipër, me anë të dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E. nga operatori ekonomik “S.S.X” sh.p.k. vërtetohet se ka shlyer të gjithë detyrimet tatimore në fuqi. Kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Pra, KPP gjykon se operatori ekonomik “S.S.X” sh.p.k., i përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dea Security” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dea Security” shpk, për kundërshtimin e për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk, me pretendimin se: *“Së dyti, autoriteti kontraktor duhet të skalifikojë shoqëritë Eurogjici Security, S.S.X, Snajper Security, START 2000, Toni Security dhe Trezhnjeva pasi këto shoqëri nuk plotësojnë kërkesën e dhënë në dst, 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, 2.1 “Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomike”, pika 3, certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 11 punonjës shërbimi nga të cilët minimalisht 1 (një) punonjëse të jetë femër, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë. Pra këto shoqëri nuk përmbushin kapacitetin ligjor pasi nuk kanë paraqitur 11 punonjës shërbimi nga të cilët minimalisht 1 (një) punonjëse të jetë femër, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.2.1 Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.1.3 të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin:

2.1.3. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 11 punonjës shërbimi nga të cilët minimalisht 1 (një) punonjëse te jetë femer , të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektornike operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur ka dorëzuar përkatësisht dokumentacionin si vijon:

- *“Eurogjici Security” shpk ka dorëzuar 104 (njëqind e katër) certifikata punonjësish shërbimi brenda afatit 4 vjeçar, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, nga të cilat 3 (tre) certifikata janë për punonjëse shërbimi femra.*
- *“Mandi 2K” shpk ka dorëzuar 41 (dyzet e një) certifikata punonjësish shërbimi, brenda afatit 4 vjeçar, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, nga të cilat 1 (një) certifikatë është për punonjëse shërbimi femër.*
- *“Nazeri 2000” shpk ka dorëzuar 19 (nëntëmbëdhjetë) certifikata punonjësish shërbimi brenda afatit 4 vjeçar, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, nga të cilat 1 (një) certifikatë është për punonjëse shërbimi femër.*
- *“Snajper Security” shpk ka dorëzuar 11 (njëmbëdhjetë) certifikata punonjësish shërbimi brenda afatit 4 vjeçar, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, nga të cilat 1 (një) certifikatë është për punonjëse shërbimi femër.*
- *“Start 2000” shpk ka dorëzuar 12 (dymbëdhjetë) certifikata punonjësish shërbimi brenda afatit 4 vjeçar, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, nga të cilat 1 (një) certifikatë është për punonjëse shërbimi femër.*
- *“S.S.X” shpk ka dorëzuar 14 (katërmëdhjetë) certifikata punonjësish shërbimi brenda afatit 4 vjeçar, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, nga të cilat 1 (një) certifikatë është për punonjëse shërbimi femër.*
- *“Toni Security” shpk ka dorëzuar 47 (dyzet e shtatë) certifikata punonjësish shërbimi brenda afatit 4 vjeçar, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, nga të cilat 2 (dy) certifikata janë për punonjëse shërbimi femër.*
- *“Toni Security” shpk ka dorëzuar 19 (nëntëmbëdhjetë) certifikata punonjësish shërbimi brenda afatit 4 vjeçar, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, nga të cilat 1 (një) certifikatë është për punonjëse shërbimi femër.*

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.2.4. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.2.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.6. Neni 5 i Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikon shprehimisht se: “1. Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut.

3. Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së.

4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësin e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim.

5. Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësin e shërbimit.”.

III.2.7. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”

III.2.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Dea Security” shpk, për skualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk, KPP konstaton se këta ofertues kanë paraqitur secili prej tyre nga 1 (një) certifikatë punonjësi

shërbimi femër, të lëshuara nga DVP Tiranë dhe brenda afatit 4-vjeçar të vlefshmërisë të parashikuar në nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 *“Për shërbimin privat të sigurisë fizike”*.

Konstatohet se autoriteti kontraktor në këtë procedurë prokurimi ka përcaktuar kërkesën për paraqitjen e 11 (njëmbëdhjetë) certifikata punonjësish shërbimi të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Tiranë, nga të cilët minimalisht 1 (një) punonjëse të jetë femër.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëritë “Eurogjici Security” shpk, “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk e kanë plotësuar kërkesën për kualifikim të dhënë nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi këto shoqëri kanë paraqitur nga 1 (një) certifikatë punonjësi shërbimi femër, të lëshuara nga DVP Tiranë dhe brenda afatit 4-vjeçar të vlefshmërisë të parashikuar në nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 *“Për shërbimin privat të sigurisë fizike”*.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatorët ekonomikë të sipërpërmendur e përmbushin kriterin e përcaktuar në shtojcën 7 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”* pika 2.1.3 të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pasi kanë paraqitur nga 1 (një) certifikatë punonjësi shërbimi femër, të lëshuara nga DVP Tiranë dhe brenda afatit 4-vjeçar të vlefshmërisë, sikurse ka kërkuar autoriteti kontraktor në këtë kriter.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik *“Dea Security”* shpk, nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik *“Dea Security”* shpk, për kundërshtimin e për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë *“Eurogjici Security”* shpk, *“Mandi 2K”* shpk, *“Nazeri 2000”* shpk, *“S.S.X”* shpk, *“Snajper Security”* shpk, *“Start 2000”* shpk, *“Toni Security”* shpk dhe *“Trezhnjeva”* shpk, me pretendimin se: *“Së treti, , autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë shoqëritë Eurogjici Security, S.S.X, Snajper Security, START 2000, Toni Security dhe Trezhnjeva pasi këto shoqëri nuk i plotësojnë kërkesën e dhënë në dst, 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 3, Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik. Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik. Këto shoqëri nuk përmbushin kapacitetin ekonomik pasi në vërtetimin e performancës së lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë kanë masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.3.1. Në Shtojcën 7 *“Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”* pika 2.3.3 *“Kapaciteti teknik”* të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

3. Dokumenti i Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku jepet ky informacion dhe që nuk ka masa administrative për operatorin ekonomik dhe drejtuesin teknik.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatorët ekonomikë *“Eurogjici Security”* shpk, *“Mandi 2K”* shpk, *“Nazeri 2000”* shpk, *“S.S.X”* shpk, *“Snajper Security”*

shpk, “Start 2000” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Vërtetim Nr. 78/32 prot, datë 16.04.2020, për operatorin ekonomik “Eurogjici Security” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku përcaktohet se: “Në Pikën II, të këtij vërtetimi citohet se: a. “Masat administrative të dhëna nga DVP gjithsej 2 (dy).

Në pikën VII. Vlerësimi përmbledhës për performancën e SHPSF “Eurogjici Security”, të kategorisë 1.3.A: Subjekti i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike “Eurogjici Security”, të kategorisë 1.3.A, me seli në Tiranë ka punuar në përgjithësi mirë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe ka bashkëpunuar me D.V.P Tiranë.”.

Vërtetim Nr. 293/12 prot, datë 04.06.2020, për operatorin ekonomik “Mandi 2K” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku përcaktohet se: “Në Pikën IV, të këtij vërtetimi citohet se: “Masat administrative të dhëna nga DVP gjithsej nuk ka. Ngjarje të ndodhura nuk ka. Në pikën VII. Vlerësimi përmbledhës për performancën e SHPSF “Mandi 2K”, të kategorisë 1.3.A: Subjekti i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike “Mandi 2K”, të kategorisë 1.3.A, me seli në Tiranë ka punuar mirë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe ka bashkëpunuar me D.V.P Tiranë.”.

Vërtetim Nr. 68/81 prot, datë 16.04.2020, për operatorin ekonomik “Nazeri 2000” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku përcaktohet se: “Në Pikën IV, të këtij vërtetimi citohet se: “Masat administrative të dhëna nga DVP gjithsej nuk ka. Ngjarje të ndodhura nuk ka. Në pikën VII. Vlerësimi përmbledhës për performancën e SHPSF “Nazeri 2000”, të kategorisë 1.3.A: Subjekti i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike “Nazeri 2000”, të kategorisë 1.3.A, me seli në Tiranë ka punuar mirë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe ka bashkëpunuar me D.V.P Tiranë.”.

Vërtetim Nr. 1824/46 prot, datë 30.04.2020, për operatorin ekonomik “Snajper Security” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku përcaktohet se: “Në Pikën IV, të këtij vërtetimi citohet se: “Masat administrative të dhëna nga DVP gjithsej nuk ka. Ngjarje të ndodhura nuk ka. Në pikën VII. Vlerësimi përmbledhës për performancën e SHPSF “Snajper Security”, të kategorisë 1.3.A: Subjekti i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike “Snajper Security”, të kategorisë 1.3.A, me seli qendrore në Dibër dhe me aktivitet në Tiranë ka punuar mirë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe ka bashkëpunuar me D.V.P Tiranë.”.

Vërtetim Nr. 538/7 prot, datë 22.04.2020, për operatorin ekonomik “S.S.X” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku përcaktohet se: “Në Pikën IV, të këtij vërtetimi citohet se: “Masat administrative të dhëna nga DVP gjithsej nuk ka. Ngjarje të ndodhura nuk ka. Në pikën VII. Vlerësimi përmbledhës për performancën e SHPSF “S.S.X”, të kategorisë 1.3.A: Subjekti i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike “S.S.X”, të kategorisë 1.3.A, me seli në Tiranë ka punuar mirë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe ka bashkëpunuar me D.V.P Tiranë.”.

Vërtetim Nr. 299/14 prot, datë 24.06.2020, për operatorin ekonomik “Start 2000” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku përcaktohet se: “Në Pikën V, të këtij vërtetimi citohet se:

“Masat administrative të dhëna nga DVP gjithsej nuk ka. Ngjarje të ndodhura nuk ka. Në pikën VII. Vlerësimi përmbledhës për performancën e SHPSF “Start 2000”, të kategorisë 1.3.A: Subjekti i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike “Start 2000”, të kategorisë 1.3.A, me seli në Tiranë ka punuar mirë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe ka bashkëpunuar me D.V.P Tiranë.”.

Vërtetim Nr. 191/40 prot, datë 08.05.2020, për operatorin ekonomik “Toni Security” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku përcaktohet se: “Në Pikën III, të këtij vërtetimi citohet se: “Masat administrative të dhëna nga DVP gjithsej ka 2 (dy). Ngjarje të ndodhura nuk ka. Në pikën VII. Vlerësimi përmbledhës për performancën e SHPSF “Toni Security”, të kategorisë 1.3.A: Subjekti i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike “Toni Security”, të kategorisë 1.3.A, me seli në Tiranë ka punuar në përgjithësi mirë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe ka bashkëpunuar me D.V.P Tiranë.”.

Vërtetim Nr. 723/37 prot, datë 30.04.2020, për operatorin ekonomik “Trezhnjeva” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku përcaktohet se: “Në Pikën III, të këtij vërtetimi citohet se: “Masat administrative të dhëna nga DVP gjithsej ka 1 (një). Ngjarje të ndodhura nuk ka. Në pikën VII. Vlerësimi përmbledhës për performancën e SHPSF “Trezhnjeva”, të kategorisë 1.3.A: Subjekti i Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike “Trezhnjeva”, të kategorisë 1.3.A, me seli në Kukës – Tropojë dhe me aktivitet në Tiranë ka punuar mirë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe ka bashkëpunuar me D.V.P Tiranë.”.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.3.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.3.5. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton se operatorë ekonomikë “Mandi 2K” shpk, “Nazeri 2000” shpk, “S.S.X” shpk, “Snajper Security” shpk dhe “Start 2000” shpk, në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit ka paraqitur dokumentacionin e duhur që vërteton pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik, vërtetimin e lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku evidentohet se operatorët ekonomikë të mësipërcituar masa administrative nga Drejtoria Vendrore e Policisë Tiranë, si dhe ka vlerësim pozitiv nga ana e kësaj të fundit, duke përmbushur kërkesën e mësipërme për kualifikim ndërsa operatorë ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit ka paraqitur dokumentacionin për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik, vërtetimin e lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ku evidentohet se këta operatorë ekonomikë kanë masa administrative nga Drejtoria Vendrore e Policisë Tiranë, si dhe kanë vlerësim përgjithësisht pozitiv nga ana e kësaj të fundit, duke mospërmbushur kërkesën e mësipërme për kualifikim.

III.3.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit operatorit ekonomik “Dea Security” shpk qëndron pjesërisht.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Dea Security” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-59490-06-01-2020, me objekt: “Shërbim me roje private” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 6.864.034,83 lekë (pa-TVSH) zhvilluar më datë 22.06.2020, nga autoriteti kontraktor Insituti i Shëndetit Publik, Tiranë..

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk, “Toni Security” shpk dhe “Trezhnjeva” shpk, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Dea Security” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 827 Protokolli; Datë 24.07.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri